POSTIM ARKIVOR

# Fan Noli (1882-1965)

Fan Noli në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit


Emërtimi i institucionit DREJT. SIG. SHTETIT
Emërtimi i sektorit ZB. POLITIK
Viti 1943

DOSJA Nr. 3

TITULLI I DOSJES

FASHIKULL ME MATERIALE NE NGARKIM TE FAN-NOLIT-

Afati i ruajtjes
Sasia e fletëve 76

Ka filluar më 1943
Ka mbaruar më 1964
Numuri rendor i inventarit

AIDSSH

SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1957 - 1964

Në vitet ’50, kur Sigurimi i Shtetit i hapi dosje fashikull Fan Nolit , ai jetonte prej më shumë se 20 vjetësh në SHBA. Pas Luftës së Dytë Botërore kishte mbështetur qeverinë shqiptare dhe përpiqej për njohjen e Shqipërisë nga qeveria e SHBA-së. Me reputacion të lartë në diasporë, ai ishte president nderi i “Vatrës” dhe drejtonte Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare në SHBA, të themeluar prej tij. Në këtë periudhë, mes pakënaqësive ndaj politikës komuniste, Sigurimi kërkoi të forconte lidhjet me të, ndërsa Noli i kërkoi ndihmë shtetit shqiptar për dërgimin e një peshkopi dhe dy priftërinjve në SHBA, si edhe shprehu interes për ribotimin e veprës së tij dhe studimet historike shqiptare. Fan Noli (1882 - 1965) është një figurë e rëndësishme e kulturës dhe historisë shqiptare të shek. XX: klerik ortodoks, politikan, diplomat, njeri i letrave dhe muzikant. Ai ishte mbajtës i disa funksioneve shtetërore dhe publike për një periudhë të gjatë: deputet (prill 1921 - shtator 1923), ministër, kryeministër (1924), kryeredaktor i gazetës “Dielli”, kryetar nderi i shoqatës “Vatra” dhe kryepeshkop i Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë.

KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE SHQIPTARE · SHOQËRIA "VATRA" · REVOLUCIONI I QERSHORIT

# Fan Noli në dosjet e ish Sigurimit të Shtetit

Dosja formulare “Fan Noli” është hapur në vitin 1957 nga Seksioni i Zbulimit Politik në Drejtorinë e Sigurimit të Shtetit, nisur nga disa të dhëna se qëndrimi i Fan Nolit kishte ndryshuar kundrejt pushtetit popullor dhe është në mbështetje të zbulimit amerikan. Dosja tregon përpjekjen e Sigurimit të Shtetit për të afruar Fan Nolin me autoritetet komuniste shqiptare. Premisa nga e cila nisej Sigurimi ishte se relacionet e informatorëve dhe artikujt në shtypin e emigracionit në Amerikë për Fan Nolin. Dosja tregon edhe për një takim të Fan Nolit me punonjës të përfaqësisë diplomatike. Dosja është mbyllur më 1964, një vit përpara vdekjes së tij. Përmban dokumente të mbledhura të natyrave të ndryshme: artikuj, letra, kartolina, si dhe raporte, informata, relacione, etj.

Mbi Nolin

MEDIA FAQE #3



Faqe.IIIte

Ne kete problem mendoj se Fan-Noli eshte treguar indiferent me mos me teper sepse po te lonte rolin e tij si udheheqes i feso aty si do munte t'i jepte orientimin e pershtatshem dhe te bente qe kisha te zinte vendin e saj ne feste.-

Edhe organizata Vatra nuk beri shume perpjekje,nuk u tregua aktive per te pase sukses festa,shtypi i saj nuk shkruajti gati fare pamvarsisht se antaret e saj e festuan bashke me gjithe kolloninë.Pra edhe ne kete rast Fan-Noli mund te bente diçka per te popullarizuar festat edhe veçanerisht 29 Nendorin e cila nuk njihet mire nga Kollonija.-

Si perfundim pozita e Fan-Nolit?

I)Forca e pushtetit t'one ka bere qe kollonija te qendroje mire aty ay ka bazen e jetes se tij dhe vetem me nje qendrim te mire pro nesh mund te ruaje influencen e tij d.m.th.si don te ruaje influencen dhe i duket e veshtire qe tani ne vjetet e pleqeris te diskreditohet nga ane e politikas

II)Interesi personal dhe deshira per ruajtjen e pozites qe ka si Episkop jane dhe keto faktore qe bejne te jete me ne.-

III)E kaluara e tij me nje aktiv pune ne problemin nacional e lidhin gjith'ashtu me ne sepse si e din qe vetem nje sistem si ky joni mund t'ja vleresoje ate qe ka bene ose e qe do beje aty ku eshte.-

Fan-Noli prej kriminelave te luftes,Vorio-Epiroteve dhe Grekeve si dhe prej gazetave qe nxjerin keta si konsiderohet si Dhespot i Kuq (Komunist))dhe luftohet ashper -

A mund te jete ky nje agjent i Amerikaneve?Deri tani nuk ka ndonje rast konkret per vertetimin e kesaj dhe une nuk besoj qe ky te jete agjent me gjith ç'faqjet oportuniste qe duken ne shpjegimin e me siperme.-

A mund qe ky te vihet ne sherbim aktiv politik pro nesh?Kjo eshte e mundeshme ne rast se ç'frytezojme ne menyre te pershtateshme dhe te studjuara tre pikat e para permendura.

a)Te mos sulmohet hapet per gabimet qe si mund te kete bene ne te kaluaren jo vetem nga ne por edhe nga kreret e Shqiperis se Lire.-

b)Te mbajne nje fare korispodence udheheqesit t'ane per disa probleme qe mund te paraqiten aty.-

c)Kisha e jone te beje korispodence dhe te perpiqet qe t'a marre ne mvartesin e saj.-

ç)Me qene se si eshte nje historian dhe letrar te caktohet antar nderi i Lidhjes te Shkrimtareve dhe Kryesija te korespondoje me te.-

d)Te shihet dhe problemi financjer i tij.-

u shtyp ne tre kopje
Dakt.M.Shemeti.-

AIDSSH

Mbi Nolin

INFORMACION

## Mbi Nolin

| | |
|---|---|
| DOSJA | Nr. 3 |
| STRUKTURA | Drejtoria e Sigurimit të Shtetit/Sektori i Zbulimit Politik |
| VITET EKSTREME | 1943-1964 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| SASIA E FLETËVE | 76 |
| GJUHA | Shqip |
| MËNYRA E RUAJTJES | Digjitale |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | SHBA |
| LIDHJA | Vatra, Kisha Ortodokse Autoqefale |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Relacion

MEDIA FAQE #1



33 (29)

RELACION MI QENDRIMIN E FANOLIT NE KOLONI

Kohet e fundit ne bisedimet qe kane bere shoket tone te Perfaqesise ne New=York me Fanolin,ay ka shprehur mendim qe Kisha jone Autoqefale,ne bashkepunim me Qeverine,te dergoje ne Amerike nji peshkop tjeter dhe nja dy prifterinj,pasi sipas tij ay sot eshte shume plak dhe pas vdekjes se tije ka rezik qe kisha Shqiptare ne Amerike,te bjere ne duarte e i cili eshte njeriu i Grekeve.

Shoket e Perfaqesise tone i kane premtuar se nji gje te tille do tja referojne Organeve kopetente ne vendin tone.

Ne bisedimet qe kane bere Shqiptaret qe kane erdhur nga Amerika si turiste,kane treguar mi poziten e Fanolit sot ne Koloni.Organizata "Shqiperi e Lire"eshte interesuar qe Fanoli te largohet si Kryetar Nderi i "Vatres"dhe te behet kryetar Nderi i gjithe Kolonise Shqiptare,d.m.th. i te dy Organizatave.

Kete ata e arsyetojne me faktin,se largimi i Fa=nolit drejt per drejt nga Vatra do te dobesoje influencen e Qerim Panaritit ne kete Organizate.Nji gje te tille Organizata Shqiperi e Lire e ka kerkuar zyrtarisht ,mirepo Organizata e Vatres nuk ka pranuar.

Ne qofte se do ndermereshe nji hap i tille,do te bente te mundur,jo vetem largimin e Qerim Panaritit nga "Vatra" pasi sic dihet ay gezon perkrahjen e Fanolit,por do te hithte the=melet e nji bashkimi midis Organizatee "Shqiperi e Lire" dhe Vatres.

Fanoli tani eshte plakur mjaft,keshtu dhe manifesti meve politike ay ju shmanget.Me gjith kete autoriteti i tij ne Ko=lonë është i math.

Nisur nga keto do te bente nji efekt te math po litik ne qofte se ay do te vinte te vizitonte Shqiperine.Per kete jemi te mendimit qe atij ti dergohet nji ftese zyrtare nga ana e Lidhjes Shkrimtarvet ose ndonji institut tjeter.

DREJTORI I ZBULIMIT POLITIK
GJENERAL MAJOR
( ZOI THEMELI )

AIDSSH

Relacion

INFORMACION

## Relacion

| | |
|---|---|
| DREJTORI I ZBULIMIT POLITIK | Zoi Themeli |
| FONDI | 6 |
| STRUKTURA | Drejtoria e Tretë e ish-Sigurimit të Shtetit |
| DOSJA | Nr. 3 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Fashikull |
| SASIA E FLETËVE | 76 |
| VITET EKSTREME | 1943-1964 |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Letër nr. 2, datë30.3.1958 drejtuar "Kështjellës"

MEDIA FAQE #1



Leter No 2 Pozite date 30 -XII-1958

"Tanoli" 50 (46)

"K E S H T J E L L E S"

Pozite

Ketu poshte po ju paraqisim disa informata qe kemi mbledhur nga burime te ndryshme mbi qendrimin e Fan S.Nolit dhe mbi"Shpatin".

Pragrafi i 1re.-Mbi Qendrimin e Fan S.Nolit.-

Nga sa jemi informuar nga shqiptare te ndryshem te kollonis,Peshkop Fan Noli vazhdon te mbaje qendrim jo kunder nesh.Ai ka mbetur i kenaqur qe disa nga veprat e tij jane ribotuar rishtaz ne Shqiperi.Gjithashtu, ne bisedimet e tij me shqiptare patriote,nuk flet kunder politikes sone te brendeshme dhe te jashtme.Fan Noli ka marre kontakt me shqiptaret e Amerikes qe kane vizituar Shqiperine kohet e fundit dhe esht interesuar per gjendjen ne vendin tone.Ne nje fjalim qe kishte mbajtur me 19 tetor, Fan Noli kishte permendur se nuk jane te verteta fjalet qe kishin qarkulluar se qeveria shqiptare paskish burgosur Pesshkop Kissin."Ne nje vizite qe beri Dr.J.Nasse ne Shqiperi -kish thene Fan Noli - bashkoj Peshkop Kissin dhe mundi te mesoje nga goja e tij se fjalet qe jane perhapur se gjoja qeveria e sotme e ka burgosur nuk ishin te verteta".(Shif fleten e prere nga gazeta "Liria" e 7 nendorit 1958 qe bashkangjisim).Ne nuk dijme se pse interesohet shume Fan Noli per Peshkop Kissin dhe nuk kuptojme ne se ky interesim i tij mund te kete nonje lidhje me rrethanat e vdekjes se Kissit,por ajo qe duket me rendesi lidhur me kete ceshtje esht se Fan Nolit i esht bere shume qejfi qe Kissi nuk ka qene i burgosur.

Me 30 nendor te 1958es,me rastin e nje mbremje qe ishte organizuar ne Boston per te festuar diten e 28 nendorit,Fan Noli kishte mbajtur nje fjalim.Nga nje permbledhje qe ishte botuar ne "Diellin" e 10 dhjetorit, veme re re Peshkop Noli kishte fole mbi historin e luftes se popullit shqiptar per liri e te tjera dhe kishte perfunduar me disa komente mbi Shqiperin e sotme.Per kete te fundit "Dielli" shkruante:"......Hiresia perfundoj fjalimin e tij shume interesant e te kendshem me disa komente mbi Shqiperin e sotme,dyke thene se kur te permiresohet gjendja nderkombetare pergjithesisht,atehere dhe Shqiperise do ti veje puna me mbare".Ne

AIDSSH

Letër nr. 2, datë30.3.1958 drejtuar "Kështjellës"

MEDIA FAQE #2



-2-

(47) 51

Nuk dijme akoma me me hollesi se ç'ka thene ky lidhur me gjendjen ne Shqiperi - per kete do te hetojme - por,nga sa mund te kuptohet nga keto rreshta te "Diellit",nuk do te kete fole keq.

"Ngjala" na tha se nja dy vjet me pare Fan Noli ishte ftuar nga organet amerikane te propagandes qe te mbante nje fjalim ne radio kunder shtetit tone por ai kishte refuzuar duke u thene:"Nuk mund te behem une shkaktar qe te behen gjakderdhje ne Shqiperi".Pas kesaj Fan Nolit i esht bere presjon dhe [redacted] i kishte thene "Ngjales" se Peshkopi do te therritesh per pyetje para Komitetit per veprimtari anti-amerikane. Ne te vartete ai nuk u thirr para atij Komiteti por ketu flitet se organet qeveritare amerikane nuk e kane ne sy te mire.Kjo do te jete arsyeja, ndoshta,qe Fan Noli ka frike dhe rezervohet te flasi ne favorn tone.Ne na eshte thene gjithashtu se dhe kur Peshkop Noli ka derguar telegramin e protestes per mos pranimin nga ana jone te"ndihmave" amerikane ate e ka bere se ka qene i detyruar dhe se ne bisedime private me pastaj kishte thene se qeveria shqiptare "beri mire" qe nuk i pranoi"ndihmat".

Lidhur me rrugen tradhetare qe ka marre dhe vazhdon "Vatra" shume njerez nga te kollonis ketu ja hedhin fajin Fan Nolit.Pa e çfajsuar ate plotesisht lidhur me kete gjendje,neve mendojme se pergjegjesia me e madhe rendon mbi elementat armiq si [redacted] e te tjere te cilet duhet te punojne nen drejtimin e organeve amerikane te propagandes.Kur u takua "Tomorri" me Fan Nolin,ne vere te ketij viti,i vuri ne dukje se "Dielli" mban qendrim anti-shqiptar.Fan Noli heshti fare lidhur me kete pike dhe u vu re ne ate rast se ishte shume i tronditur lidhur me problemin.

AIDSSH

Letër nr. 2, datë30.3.1958 drejtuar "Kështjellës"

INFORMACION

## Letër nr. 2, datë30.3.1958 drejtuar "Kështjellës"

| | |
|---|---|
| DREJTUAR | "Kështjellës" |
| BURIMI | Të ndryshme |
| FONDI | 6 |
| DOSJA | nr. 3 |
| VITET EKSTREME | 1943-1964 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Fashikull |
| SASIA E FLETËVE | 76 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | SHBA |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Telegram

MEDIA FAQE #1



57 61

"Luani" me telin Nr.141 date 10.6.59 njeftona:

Faneli e sheh kohe te pershtatshme tani per te shkuar Delegacioni nga "Vatra" dhe "Lirija" qe te kerkoje nga Departamenti i Shtetit njehjen e Shqiperise.Ky eshte nji plani i vete Fanelit dhe ai per kete ka filluar bisedimet me kryesine e Organizatave ne fjale.Faneli menden qe te nderhyje tek vete Herteri pse Shqiptaret e njefin ate qysh nga koha kur ka qene ne Basten si Guverner.

N/Kol.Rasimi shenon.

Xhele:Tregoja Gjeneralit.

U nxuar ne dy kopje,nji ne dosjen e Fan Nolit dhe tjetra ne dosjen e telegramave.15/6/59.Teg.S.Backa

AIDSSH

Telegram

INFORMACION

## Telegram

| | |
|---|---|
| LLOJI | Telegram |
| DATË | 10.6.1959 |
| FONDI | 6 |
| STRUKTURA | Drejtoria e Zbulimit Politik |
| DOSJA | Nr. 3 |
| SASIA E FLETËVE | 76 |
| VITET EKSTREME | 1943-1964 |
| | SHBA |

| | |
|---|---|
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | |
| GJUHA | Shqip |
| DATA E KRIJIMIT | 15.06.1959 |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Telegram |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

# Balli Kombëtar i përgjigjet Fan Nolit

MEDIA FAQE #1


BALLI KOMBETAR

Nr. 1 Janar 1950

LETER E HAPUN

BALLI KOMBETAR I PERGJIGJET FAN. S. NOLIT

Balli Kombëtar i përgjigjet Fan Nolit

INFORMACION

## Balli Kombëtar i përgjigjet Fan Nolit

| | |
|---|---|
| GAZETA | Balli Kombëtar |
| NUMRI/DATA | Nr. 1, janar 1950 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Kartolinë falenderimi e Fan Nolit

MEDIA FAQE #1


May the blessings of His Love be near At Easter Time and all the year.

Abide in me, and I in you.
SAINT JOHN 15:4

An Easter Prayer

N'emër të Kishës Orthodoks
Shqipëtarë n'Amerik dëshëroj
t'ju falendëroj për dorë-hapjen
të dhuratës me ushqime për
popullin e Shqipërisë që
vdesin prej uries. Kjo dhuratë
do të jetë e mirë-njohur prej
të gjithë Shqiptarët që dinë
se Amerika [illegible] dashurnar
për liri ka qenë gjithnjë
edhe akoma qëndron miku
më i mirë së tyre.

FAN NOLI

Kartolinë falenderimi e Fan Nolit

INFORMACION

## Kartolinë falenderimi e Fan Nolit

| | |
|---|---|
| LLOJI I DOKUMENTIT | Kartolinë |
| DATA E KRIJIMIT | Pa datë |
| FONDI | 6 |
| STRUKTURA | Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Sektori i zbulimit politik |
| DOSJA | nr. 3 |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Foto e një kryqi

MEDIA FAQE #1




Foto e një kryqi

MEDIA FAQE #2



Foto e një kryqi

INFORMACION

## Foto e një kryqi

| | |
|---|---|
| FONDI | 6 |
| DOSJA | nr. 3 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Fashikull |
| STRUKTURA | Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, sektori i zbulimit politik |
| VITET EKSTREME | 1943-1964 |
| SASIA E FLETËVE | 76 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | SHBA |
| GJUHA | Anglisht, shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.